



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUHAJ
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1
Tirane
TEL: 0692097547

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 720

Nr. koleksioni: 274

Tirane më 07/02/2024

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10/07/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

Akti noteriali përbehet nga 4 fletë



A2024053540027727565



A2024053540027727563

AKT THEMELIMI
I
"REZON.ING HOLDING" SHPK

Sot, më datë 07/02/2024 (dymijë e njëzet e katër), përpara meje Zv. Notere Ina Papa, në bazë të autorizimit me nr. 5 Prot., datë 30.01.2024 dhe në bazë të urdhërit të emërimit me nr. 3950/1Prot., datë 16.06.2023 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, me zyrë në adresën Tiranë, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tiranë, u paraqitën personalisht:

THEMELUESIT:

1. **Ramadan Idrizaj**, atësia Miftar, amësia Remzije, shtetas Shqiptar, lindur në Zhyr, Kosova (XKS) dhe banues në DURRËS, me adresë Agaveve 00690029; Nd. 58; H. 3; Ap. 20; Durrës; Durrës; 2008; Durrës, lindur më 17/04/1953, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 034613235 dhe nr. personal F30417143CI, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 544, Nr. kol 205, hartuar nga notere Mimoza Sadushaj, në datë 29/01/2024, nga përfaqësues **Krenar Loloçi**, atësia Kadri, amësia Hano, shtetas shqiptar, lindur në Beograd, Serbia (SRB) dhe banues në Tiranë, me adresë ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, lindur më 11/07/1957, gjendja civile i martuar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal F70711049E;
2. **Arian Idrizaj**, Ramadan, shtetas Kosovar, lindur në Prizren dhe banues në Kosove, me adresë Rruga Mbreti Zog nr.1, lindur më 23/02/1977, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Kosovare nr. P00935833, i përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokurë e huaj" me Nr. 972, në datë 01/02/2024, nga përfaqësues **Krenar Loloçi**, atësia Kadri, amësia Hano, shtetas shqiptar, lindur në Beograd, Serbia (SRB) dhe banues në Tiranë, me adresë ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, lindur më 11/07/1957, gjendja civile i martuar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal F70711049E.

Neni 1

Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria emërtohet "REZON.ING HOLDING " SHPK (në vijim "**Shoqëria**").
- 1.2 Shoqëria themelohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("Ligji 9901/2008") dhe sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Ibrahim Rugova, Nd. 70, Hyrja 5, Ap. 5, Tiranë, 1019, Shqipëri.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e veprimtarive të mëposhtëme:



- a. Projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi dhe operimi i strukturave hoteliere dhe/ose objekteve turistike sezonale, administrimi i tyre, ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit, si dhe çdo lloj veprimtarie tjetër plotësuese që lidhet drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë me veprimtarinë e sipërpërmendur.
- b. Projektimi dhe zbatimi si kontraktor apo nënkontraktor në fushën e ndërtimit, i ndërtimeve civile - industriale; duke përfshirë ndërtime dhe rikonstruksione të ndërtesave civile dhe industriale, ujësjellësa, kanalizim, dhe trajtim të ujrave, punime në infrastrukturë rrugore, punime strukturore speciale, veshje fasadash, impiante ndriçuese, punime topogjeodezike, pastrim i ujërave të detit dhe lumore.
- c. Kryerja e veprimeve të tjera që lidhen me pasuritë e paluajtshme të tilla si marrja dhe dhënia me qera, posedimi, hipotekimi, dhënia e garancive në lidhje me pasuritë e paluajtshme.
- d. Aktivitete të marketingut, reklamimit dhe tregtimit, të tilla si përpunim të dhënash; krijim dhe administrim i bazave të të dhënave; kërkim tregu dhe analizë e opinionit publik; edukim dhe trajnim i personave madhorë.
- e. Krijimi i faqeve web, platformave elektronike në internet dhe aplikacioneve me synim zhvillimin, nxitjen dhe promovimin e aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 4 Afati i Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë për një afat kohor të pacaktuar.
- 4.2 Shoqëria mund të priset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 5 Kapitali themeltar, Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga dy kuota, njëra kuotë në vlerën 51,000 lekë ose 51% e kapitalit të Shoqërisë dhe kuota tjetër në vlerën 49,000 lekë ose 49% e kapitalit të Shoqërisë.
- 5.2 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen si në vijim:
 - Z. Ramadan Idrizaj, shtetas shqiptar, i biri i Miftarit dhe Remzijas, lindur në Zhyr, Kosovë, më 17/04/1953 zotëron një kuotë në vlerën 51,000 lekë ose 51% të kapitalit të Shoqërisë;
 - Arian Idrizaj, shtetas kosovar, lindur në Prizren, Kosovë, më 23.02.1977, zotëron një kuotë vlerën 49,000 lekë ose 49% të kapitalit të Shoqërisë.
- 5.3 Pjesëmarrja e ortakëve dhe zotërimi nga ana e tyre i kapitalit të Shoqërisë jepet në mënyrë analitike në tabelën e mëposhtme:

Ortaku	Kuota	% në kapital	Vlera
Ramadan Idrizaj	1(një)	51%	51,000 Lekë
Arian Idrizaj	1(një)	49 %	49,000 Lekë

Neni 6 Organet e Shoqërisë



Organet e Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë dhe Administratorët e Shoqërisë.

Neni 7 Administratorët

7.1 Administratorë të parë të shoqërisë emërohen:

- Z. Ramadan Idrizaj, shtetas shqiptar, i biri i Miftarit dhe Remzijas, lindur në Zhyr, Kosovë, më 17/04/1953, emërohet administrator i Shoqërisë për një periudhe 5 (pesë) vjeçare, duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti themelimi.

-Z. Arian Idrizaj, shtetas kosovar, i datëlindjes 23.02.1977 emërohet administrator i Shoqërisë për një periudhe 5 (pesë) vjeçare, duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti themelimi.

7.2 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në Ligjin 9901/2008;
- të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose ky statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të Shoqërisë;
- të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- **Në lidhje me veprimtarinë bankare të Shoqërisë**, të dy administratorët kanë të drejtë të hapin llogari bankare pranë një ose disa bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, të marrin statement (bilanc të gjendjes) së llogarisë bankare dhe në përgjithësi të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin dhe mirëmbajtjen e llogarive.

Neni 8

8.1 Ortakët e Shoqërisë mund të emërojnë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008 si dhe të akteve të tjera të zbatueshme.

8.2 Brunilda Stefa caktohet ekspert i parë kokntabël me anën e këtij statuti.

Neni 9 Dispozita të fundit

9.1 Akti i themelimit nënshkruhet në 3 kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

9.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin apo zbatimin e dispozitave të Statutit, që shoqëron këtë Akt Themelimi, midis ortakëve apo midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve. Nëse një marrëveshje e tillë nuk arrihet, gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit është Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nënshkruar në Tiranë, sot më 07/02.2024


ORTAKËT

Ramadan Idrizaj

Arian Idrizaj

Të përfaqësuar nga :

Krenar Loloçi

Krenar Loloçi




ZEVENDESNOTERE

INA PAPA





PROKURË E PËRGJITHSHME PËR THEMELIMIN DHE REGJISTRIMIN E NJË SHOQËRIE TË RE	
Sot, më datë një shkurt dy mijë e njëzet e kater, paraqitet personalisht:	
Z. Arian Idrizaj , shtetas kosovar, i datëlindjes 23.02.1977, në Prizren, Kosovë, identifikuar me anë të mjetit të identifikimit, lloji pasaportë me nr. P00935833 ;	
Z. Arian Idrizaj emëron dhe cakton si përfaqësues të autorizuar të tij, Av. Krenar Loloçi, me banim në Tiranë, ID 033105055 , Av. Vera Batalli, me banim në Tiranë, ID 035459176 dhe Av. Marsilda Shima, me banim në Tiranë, ID 036850113 , (" Përfaqësuesit "), të cilëve u jep tagra për ta përfaqësuar vec e vec dhe bashkarisht, në lidhje me themelimin e një shoqërie të re sipas të drejtës shqiptare (" Shoqëria ") ku i Përfaqësuari do të zotërojë 49% të kapitalit të saj dhe babai i të Përfaqësuarit, Z. Ramadan Idrizaj, do të zotërojë 51% të atij kapitali;	
-	Përfaqësuesit autorizohen të ndjekin të gjitha procedurat në lidhje me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar të mbajtur dhe administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, konkretisht të hapin llogari në emër të shoqërisë në platformën e-Albania dhe të kryejnë nëpërmjet saj procedurën e regjistrimit të shoqërisë në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të plotësojnë formularin përkatës, të hartojnë dhe nënshkruajnë dokumentat që mund të kërkohen gjatë procesit të themelimit dhe të regjistrimit në emër të Shoqërisë, të mbajnë korrespondencën me regjistrin tregtar, dhe në përgjithësi të ndjekin të gjitha hapat e nevojshëm dhe të duhur deri në themelimin e plotë të Shoqërisë;
-	Të aplikojnë në lidhje me pajisjen me nënshkrim elektronik të administratorit të Shoqërisë, dhe në këtë kuadër janë të autorizuar të ndjekin dhe të kryejnë procedurën e duhur pranë Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të kryejnë pagesën përkatëse dhe të nënshkruajnë cdo dokument apo formular që mund të kërkohet në lidhje me këtë procedurë;
-	Në lidhje me regjistrimin e pronarëve përfitues, sipas Ligjit 112/2020 "Për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues", Përfaqësuesit janë të autorizuar të ndjekin procedurën përkatëse të regjistrimit të pronarëve përfitues të Shoqërisë në regjistrin e pronarëve përfitues, duke nënshkruar edhe deklaratat përkatëse të kërkuara nga Ligji 112/2020, në emër të ortakëve të Shoqërisë;
-	Përfaqësuesit janë të autorizuar të kryejnë procedurat përkatëse në lidhje me porositjen dhe marrjen e vulës në emër të Shoqërisë, duke kryer edhe pagesat përkatëse.
-	Përfaqësueset janë të autorizuar të kryejnë edhe cdo veprim tjetër që mund të kërkohet deri sa Shoqëria të regjistrohet dhe të vazhdojë normalisht aktivitetin e saj.

ARIAN IDRIZAJ

Z. Arian Idrizaj: _____;

Datë: 01.02.2024.





REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER
SEFADIN BLAKAJ
PRISHTINË

LRP. Nr: 972/ 2024;

Vërtetim nënshkrimi -----

Sefadin Blakaj, Noter në Prishtinë, Rr. "Fehmi Agani", Nr. 21/3-1, Vërteton se: -----
Nënshkrimi në fund të këtij dokumenti i njëjti i titulluar si " **Prokurë e Përgjithshme për themelimin dhe regjistrimin e nje shoqerie te re** ", është vënë në emër të palës si në vijim:-----

1. Z. Arian Idrizaj i lindur në Prizren, më 23 shkurt 1977 i identifikuar sipas letërnjoftimit me nr. personal **1010001745** të lëshuar nga MPB e R. së Kosovës datë 28.02.2023 dhe me afat skadimi 27.02.2033, sipas deklaratës së palës i biri i Ramadan-it, me vendbanim në rr.Mbreti Zog, nr.1, Prishtinë, me aftësi veprimi;-----


Dokumenti nënshkrimi i të cilit vërtetohet është punuar jashtë zyrës Noteriale; Pala nuk ka kërkuar këshillim nga Noteri në lidhje me përmbajtjen e dokumentit, andaj vërtetimi i Noterit kufizohet vetëm në vërtetimin e nënshkrimit të palës dhe nuk ka të bëjë me përmbajtjen e dokumentit.. -----

Ky vërtetim i bashkëngjitet dokumentit si faqja e dytë;-----

Veprimi noterizimit u bë në Prishtinë, në zyrën e Noterit më një shkurt dy mijë e njëzet e kater. --

Shpenzimet për punën e noterit janë paguar në shumën prej 1.00 (1x1-neni 31.2) + 0.30(3x0.10-neni 42.1)= **1,30€** plus 18%TVSH të përcaktuara me UA 05/22 mbi tarifat.-----

Noter Sefadin Blakaj, M.A.: _____ ; -----





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUHAJ
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1
Tirane
TEL: 0692097547

PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 544

Nr. koleksioni: 205

Tirane më 29/01/2024

Ligjet referuese:

- 1) Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2) Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3) Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2024053540019798768



A2024053540019798768

**PROKURË E POSAÇME**

Sot, më datë 29/01/2024 (dymijë e njëzet e katër), përpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqit personalisht:

I PERFAQESUAR: Ramadan Idrizaj, atësia Miftar, amësia Remzije, shtetas Shqiptar, lindur në Zhyr, Kosova (XKS) dhe banues në DURRËS, me adresë Agaveve 00690029; Nd. 58; H. 3; Ap. 20; Durrës; Durrës; 2008; Durrës, lindur më 17/04/1953, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034613235 dhe nr. personal F30417143C, në cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë së re REZON.ING HOLDING shpk, e cila themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, si më poshtë vijon:

“Unë i përfaqësuari i mësipërm, në cilësinë e Ortakut të shoqërisë REZON.ING HOLDING shpk, ku përfaqësoj 51 % të kapitalit të Shoqërisë, emëroj si përfaqësues të posaçëm **Z. Krenar Loloçi**, atësia Kadri, amësia Hano, shtetas Shqiptar, lindur në Beograd, Serbia (SRB) dhe banues në adresën Zef Jubani; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, i datëlindjes 11/07/1957, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033746182 dhe nr. personal F70711049E, **Znj. Vera Batalli**, atësia Gjon, amësia Martë, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në adresën Frosina Plaku; Nd. 54; H. 34; Ap. 29; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, ie datëlindjes 22/12/1979, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035459176 dhe nr. personal H96222084C dhe **Znj. Marsilda Shima**, atësia Korb, amësia Fitnete, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në adresën Jusuf Alibali; Nd. Nr.2; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, ie datëlindjes 29/01/1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036850113 dhe nr. personal J35129054H të cilëve u jep tagra për ta përfaqësuar vec e vec dhe bashkarisht, në lidhje me sa në vijim:

- Përfaqësuesit autorizohen të ndjekin të gjitha procedurat në lidhje me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar të mbajtur dhe administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, konkretisht të hapin llogari në emër të shoqërisë në platformën e-Albania dhe të kryejnë nëpërmjet saj procedurën e regjistrimit të shoqërisë në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të plotësojnë formularin përkatës, të hartojnë dhe nënshkruajnë dokumentat që mund të kërkohen gjatë procesit të themelimit dhe të regjistrimit në emër të Shoqërisë, të mbajnë korrespondencën me regjistrin tregtar, dhe në përgjithësi të ndjekin të gjitha hapat e nevojshëm dhe të duhur deri në themelimin e plotë të Shoqërisë;
- Të aplikojnë në lidhje me pajisjen me nënshkrim elektronik të administratorit të Shoqërisë, dhe në këtë kuadër janë të autorizuar të ndjekin dhe të kryejnë procedurën e duhur pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të kryejnë pagesën përkatëse dhe të nënshkruajnë çdo dokument apo formular që mund të kërkohet në lidhje me këtë procedurë;

Në lidhje me regjistrimin e pronarëve përfitues, sipas Ligjit 112/2020 "Për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues", Përfaqësuesit janë të autorizuar të ndjekin procedurën përkatëse të regjistrimit të pronarëve përfitues të Shoqërisë në regjistrin e pronarëve përfitues, duke nënshkruar edhe deklaratat përkatëse të kërkuara nga Ligji 112/2020, në emër të ortakëve të Shoqërisë;

- Përfaqësuesit janë të autorizuar të kryejnë procedurat përkatëse në lidhje me porositjen dhe marrjen e vulës në emër të Shoqërisë, duke kryer edhe pagesat përkatëse
- Përfaqësuesit janë të autorizuar të kryejnë edhe çdo veprim tjetër që mund të kërkohet deri sa Shoqëria të regjistrohet dhe të vazhdojë normalisht aktivitetin e saj.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë. I përfaqësuarit deklaroi se: *"Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit e mi të posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje"*.

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarit, i cili e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e tij të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres.



Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarit. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarin.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarit nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

I PERFAQESUAR

Ramadan Idrizaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANE
NOTERE MIMOZA SADUSHAJ

Adresa: Rr. "Vaso Pasha", Pallati 13/1

tel 042266242

Nr. 5 Prot

Tiranë, më 30.01.2024

AUTORIZIM

Unë, Notere Mimoza Sadushaj, jam anëtare në degën vendore Tiranë, me seli në Rr "Vaso Pasha" Pll.13/1". Autorizoj Znj.Ina Papa, zëvendësnotere sipas urdhërit me nr. 404, datë 13.06.2023, me të cilën kam lidhur kontratë punë, të kryejë veprimtari noteriale pranë zyrës time, bazuar në nenin 63 pika 2, dhe nenin 66 pika 3, të ligjit "Për Noterinë".

Zëvendësnoterja Ina Papa, ka të drejtë të nënshkruajë akte noteriale, të kryejë veprime noteriale si dhe procedurat e transaksioneve bankare, nga data 02.02.2024 ora 15:00 deri në 12.02.2024.

NOTERE
MIMOZA SADUSHAJ

